

URDHËR
Nr. 611, datë 20.6.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË AFTËS EPIZOOTIKE TË SHFAQUR NË SHTETIN E TURQISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nga i gjithë territori i Republikës së Turqisë në territorin e Republikës së Shqipërisë:

- a) të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe derra;
- b) të materialit biologjik të pashoqëruar me test diagnostik PCR të rezultuar negativ, e bashkëlidhur certifikata shëndetësore veterinare, të kryer 21 ditë para mbledhjes së tyre;
- c) mishin e freskët;
- ç) produktet e mishit të patrajuara me të paktën me një temperaturë prej 70°C, për 30 minuta;
- d) qumështin dhe produktet e qumështit të patrajuara termikisht me një temperaturë minimale prej 72°C për 15 sekonda (temperaturë e lartë – kohë e shkurtër pasterizimi (HTST) e aplikuar 2 herë) ose çdo trajtim tjetër ku nuk vërtetohet shkatërrimi i virusit të aftës epizootike;
- dh) leshit, qimeve, lëkurëve dhe lëkurëve të papërpunuara të patrajuara ose të papërpunuara ku nuk vërtetohet shkatërrimi i virusit të aftës epizootike;
- e) ushqimit me përmbajtje proteinike dhe ushqimi i kafshëve ruminantë dhe derra të patrajuar termikisht ku nuk vërtetohet shkatërrimi i virusit të aftës epizootike.

2. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe derra, materialit biologjik, embrioneve, mishin e freskët, produktet dhe nënprodukteve të tyre, qumështin, produktet e qumështit, ushqimit me përmbajtje proteinike, leshit, qimeve, lëkurëve dhe lëkurëve të patrajuara dhe të papërpunuara dhe të ushqimit të kafshëve ruminantë dhe derra.

3. Urdhri nr. 519, datë 26.5.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së aftës epizootike të shfaqur në shtetin e Turqisë”, shfuqizohet.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj